



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJES

VENDIM
Nr. 52, datë 08/10 /2016

Për rishqyrtimin e Vendimit Nr.25 datë 02.06.2016 “Mbi ratifikimin e marrëveshjes së Përbashkët të Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës dhe Nderkomunales Zadrime

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 dat 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” (neni 3, neni 6 pika 1, neni 9, neni 10, neni 14, neni 23 pika 10, neni 26, neni 54/d, dh, e, gj germa II); pas rishqyrtimit të Vendimit Nr.25 datë 02.06.2016 “Mbi ratifikimin e marrëveshjes së Përbashkët të Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës dhe Nderkomunales Zadrime”, dhe shkresës së Prefektit Nr.478/1.Prot datë 20.06.2016, pas vënies në dispozicion të gjithë dokumentacionit që disponon Ndërkamionale Zadrime, si dhe pas ezaurimit të takimit dy palësh në zyrat e Prefekturës, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, pas rishqyrtimit të Vendimit Nr.25 datë 02.06.2016 “Mbi ratifikimin e marrëveshjes së Përbashkët të Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës dhe Nderkomunales Zadrime, në mbledhjen e tij të datës 08/10/2016

VENDOSI:

1. Plotësimin e të metave të Marrëveshjes së përbashkët mes Bashkisë Vau Dejës, Bashkisë Lezhë dhe Ndërkomunale Zadrime për Meaxhimin e Mbetjeve Urbane nga Shoqata Ndërkomunale Zadrime në zonën pjesë e Bashkisë Vau Dejës, me elementët e mëposhtëm:
 - a) Detyrimi financiar i Bashkisë Vau dejës është 1 500 000 (një milione peseqind mije) lekë Pakesimin e fondit ne programin si me poshte:

Programi 6260

Art 602

sherbim per realizimin e funksionit te pastrimit dhe mirembajtjes se territorit

me vlere 1500 000 lekë


Miratim shtese se fondit me vlere 1 500 000 lekë, per Transferime te brendshme

Programi 6260

Art 604

sherbim per realizimin e funksionit te pastrimit dhe mirembajtjes s territorit, nga Nderkomunale Zadrime

me vlere 1 500 000 lekë



- b) Ndihmë në paisje
295 kazane mbeturinash, Kamion Volvo 5 TON.
- c) Punonjës Pastrimi
1 shofer, 2 punëtor shërbimesh
2. Efektet financiare të të kësaj marrëveshje fillojnë nga data 1 korrik 2016.
3. Bashkëpunimi më shoqatën, dhe objektivi për pastrimin, nuk përbën qëllimin parësor të organizatës dhe fitimi është 0 (zero) lekë. Bashkëlidhur relazioni i detajuar kosto-analizë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.
6. U shpall sot me date 10/10/2016.

SEKRETARI
Gentian NDOJ

KRYETARI
Martin MARKU

